




KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2025
NR/BR.	01-198/25
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për pezullimin e vendimeve me nr; 01 Nr. 48, 49, 50, 51, 52, 53, 56 të datës 30.05.2025 dhe anulimin vendimit me nr. 01 Nr. 55 i datës 30.05.2025

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të merr:

VENDIM

Për pezullimin e vendimeve

1. Pezullohen vendimet me nr. 01 Nr. 48, 49, 50, 51, 52, 53, 56 të datës 30.05.2025 ndërsa anulohet vendimi me nr. 01 Nr. 55 i datës 30.05.2025.
2. Këto vendim pezullohet deri në krijimin e kushteve ligjore për procesim tutje të procedurave të këmbimit ahstu siç e parasheh Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërsa vendimi me nr. 01. Nr. 55 i datës 30.05.2025 anulohet sepse pala ka tërhequr kërkesën për këmbim.

Të bashkangjitur gjeni;

- Vendimet e Kuvendit Komunal,
- Kërkesat për rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Shkresën nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me nr. 02/463 Nr. prot. 146-1/2025 të datës 23.06.2025.

*Uk ka kala nga
MAPL-Ja
te Rishqytimit*

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 48
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligji Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.05.2025** miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NËVOJA TË FSHATIT TALINOVC I MUHAXHERËVE

I

Lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin **Talinovc i Muhaxherëve** caktohet në pjesën e parcelës kadastrale 183-0 Z.K. **Talinovc i Muhaxherëve** me sipërfaqe prej 300 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

OBLIGOHET: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të Fshatit **Talinovc i Muhaxherëve**.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e Fshatit **Talinovc i Muhaxherëve**.

IV

OBLIGOHET: Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e Fshatit **Talinovc i Muhaxherëve**, ashtu siç e Parashih Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

Muk ka kalu mgor
MAPL-ja
Te Rishqyrtohet



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 49
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligji Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të Komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR ZGJERIMIN E HAPËSIRËS SË VARREZAVE TË
FSHATIT CËRNILLË

I

Zgjerimi i varrezave në Fshatin Cërnillë caktohet në parcelën kadastrale 642-0 Z.K. Cërnillë me sipërfaqe prej 3 ari (300 m2), pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Financimi për zgjerimin e hapësirës si dhe vendosjen e rrethojës së varrezave do të bëhet nga banorët e Fshatit Cërnillë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kreytari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

! Nuk ka kolu nga
MAPL - ja
Te rishqyrtohet



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 50
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligji Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.05.2025** miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHTATORËS TË DËSHMORIT "ZEJNULLAH ZEJNA" NË FSHATIN SOJEVË.

I

Lokacioni për ndërtimin e Shtatorës të Dëshmorit "Zejnullah Zejna" në Fshatin Sojevë caktohet në pjesën e parcelës kadastrale 688-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 300 m2, pronë e Komunës së Ferizajt.

II

OBLIGOHET: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtimin e Shtatorës të Dëshmorit "Zejnullah Zejna".

III

Ndërtimi dhe financimi për shtatoren do të bëhet nga banorët e Fshatit Sojevë.

IV

OBLIGOHET: Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij ndërtimi me Kryetarin e Fshatit Sojevë, ashtu siç e Parasheh Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb-faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



Muk ka kalu nga
MAPL-ja
Te Ridhgyrtohet

Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 51
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligji Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.05.2025** miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NËVOJA TË FSHATIT SOJEVË

I

Lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin Sojevë caktohet në pjesën e parcelës kadastrale 693-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 500 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

OBLIGOHET: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Sojevë.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e Fshatit Sojevë.

IV

OBLIGOHET: Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e Fshatit Sojevë, ashtu siç e Parasheh Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

Nuk ka kall mje
MAPL-jor

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 52
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.05.2025** miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS
KADASTRALE 2342-1 Z.K. RAHOVICË PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË
KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 2262-0 Z.K. RAHOVICË
PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

I

Shpallen interes i përgjithshëm - publik pjesa e ngastrës kadastrale -2342-1 Z.K.Rahovicë, me sipërfaqe prej 447 m², pronë e Adanan dhe Adifete Mahmuti.


II

Pjesët e ngastrës kadastrale 2342-1 Z.K. Rahovicë me sipërfaqe prej 447m², shpallen interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 226-0 Z.K. Rahovicë me sipërfaqe prej 425m² pronë e Komunës së Ferizajt, kjo pronë që është shpallur interes i përgjithshëm publik është implementuar Projekti i rrugës Rahovicë - Mirash.

III

OBLIGOHET: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjellë në Kuvend të Komunës Propozim për Këmbim të këtyre njësive.

Kuk-ka koly
nga MAP1-ja
te rishqyrtohet



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 53
Data: 30.05.2025

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT TË NJËSISËS KADASTRALE 690-6 Z.K.
TALINOVC I JERLIVE

I

Ndryshohet destinimi i parcelës Kadastrale P-72217046-00690-6 Z.K. Talinovic i Jerlive me sipërfaqe prej 691 m², nga lloji i shfrytëzimit Infrastruktura, shfrytëzim aktual rrugë në TOKË NDËRTIMORE.

II

OBLIGOHET: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt t'i bëjë ndryshimet sipas këtij vendimi.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

Nuk ka kalu nga
MAPL-ja
Te ridhorytohet



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 56
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRAVE
KADASTRALE: 1059-7 DHE 1059-8 Z.K.PRELEZ I JERLIVE, PRONË E
KOMBINATIT BUJQËSOR INDUSTRIAL

I

Shpallen interes i përgjithshëm - publik pjeset e:

-Ngastrës kadastrale -1059-7 Z.K.Prelez i Jerlive, pronë e Kombinatit Bujqësor Industrial me sipërfaqe prej 2803m² dhe

-Ngastra kadastrale – 1059-8 Z.K.Prelez i Jerlive, pronë e Kombinatit Bujqësor Industrial me sipërfaqe prej 2665m².

II

Pjesët e lartëcekura shpallen interes i përgjithshëm publik me qëllim të zgjerimit të varrezave të Fshatit Prelez i Jerlive.

III

AUTORIZOHET: Kryetari i Komunës që të kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës fillimin e procedurës së shpronësimit për njësit kadastrale të përshkruara më lartë, pasi që të njëjtat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

*! Ka kalu nga MAPL-ja
por duhet te pezullohet
deri perfundim te zgjedhjeve
por njehkohesisht edhe pala
ka deshiruar neper anjet kerkeses
te organizime ketë*



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 55
Data: 30.05.2025

Në bazë të dispozitave 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë **30.05.2025** miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES TË PËRGJITHSHËM TË NGASTRAVE KADASTRALE:
3523-1 Z.K.PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E
NGASTRËS KADASTRALE 188-1 Z.K.TALINOVC I JERLIVE PRONË E KOMUNËS
SË FERIZAJT**

I

Shpallen interes i përgjithshëm publik pjesa e ngastrës kadastrale:
-3523-1 Z.K.Ferizaj, me sipërfaqe prej 490m², pronë e Qazim dhe Rifadije Mustafa.

II

Pjesa e ngastrës kadastrale -3523-1 Z.K.Ferizaj, me sipërfaqe prej 490m², pronë e Qazim dhe Rifadije Mustafa, shpallen interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 188-1 Z.K.Talinovc i Jerlive me sipërfaqe prej 350m², pronë e Komunës së Ferizajt.

III

Qëllimi i këmbimit të pjesëve të lartëcekura është me kërkesën e palës për t'i ofruar qasje me të lehtë banorëve për kyqjen në rrugën "Luigj Gurakuqi".